



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 59

29 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---------------------------------------|--|------|
| Dekret nr. 7429 datë 30.4.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 2919 |
| Dekret nr. 7430 datë 2.5.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 2919 |
| Dekret nr. 7460 datë 11.5.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... | 2920 |
| Vendim i KM nr. 284, datë 9.5.2012 | Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2012-2014 “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikimit të mjeteve motorike të vjedhura, të kontrabanduara dhe me shkelje të tjera ligjore”..... | 2921 |
| Vendim i KM nr. 286, datë 2.5.2012 | Për një ndryshim në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”..... | 2926 |
| Vendim i KM nr. 288, datë 2.5.2012 | Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve dhe shtyrjes së afatit të programit, sipas marrëveshjes kuadër të huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB), për financimin e programit “Punët e komunitetit, faza e tretë”..... | 2927 |
| Vendim i KM nr. 289, datë 2.5.2012 | Për akordim fondi financiar shtesë komunës qendër Bilisht të qarkut të Korçës, për zbatimin e projektit emergjent për ndërtimin e urës së Poloskës..... | 2928 |

| | | |
|--|--|------|
| Vendim i KM nr. 290, datë 2.5.2012 | Për një ndryshim në vendimin nr. 707, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 kv Tiranë - Podgoricë, qarku Tiranë”. | 2928 |
| Vendim i KM nr. 294, datë 2.5.2012 | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale..... | 2929 |
| Vendim i KM nr. 295, datë 2.5.2012 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ishëm, të qarkut të Durrësit..... | 2931 |
| Vendim i KM nr. 296, datë 2.5.2012 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës”, të ndryshuar..... | 2932 |
| Vendim i KM nr. 297, datë 2.5.2012 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të ish-Uzinës së Rafinimit të Bakrit, Rubik, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... | 2933 |
| Vendim i KM nr. 298, datë 2.5.2012 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Shkopeti 2” dhe “Shkopeti 3” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... | 2933 |
| Vendim i KSHOVF nr. 1, datë 9.5.2012 | Për miratimin e logos kombëtare të 100-Vjetorit të Pavarësisë, së bashku me shkrimin “100 Vjet Pavarësi” dhe për mënyrën e përdorimit të saj..... | 2934 |
| Udhëzim i MPÇSSHB nr. 4, datë 24.4.2012 | Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar..... | 2937 |
| Udhëzim i MF nr. 11, datë 14.5.2012 | Për një shtesë në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar..... | 2937 |
| Urdhër i MD nr.224, datë 25.5.2012 | Për një ndryshim në urdhrin nr. 8046, datë 2.12.2004 “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”..... | 2938 |
| Vendim i ERE nr. 40, datë 2.5.2012 | Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “GEN – I Tirana” sh.p.k..... | 2939 |
| Vendim i ERE nr. 41, datë 2.5.2012 | Për licencimin e shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... | 2940 |
| Vendim i ERE nr. 42, datë 2.5.2012 | Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie nga “Hec Vertop”..... | 2941 |

| | | |
|---------------------------------------|---|------|
| Vendim i ERE nr. 43, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... | 2941 |
| Vendim i ERE nr. 44, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... | 2942 |
| Vendim i ERE nr. 45, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese nga hec-et: “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3”, si burime të rinovueshme energjie..... | 2943 |
| Vendim i ERE nr. 46, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”..... | 2944 |
| Vendim i ERE nr. 47, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... | 2945 |
| Vendim i ERE nr. 48, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... | 2945 |
| Vendim i ERE nr. 49, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... | 2946 |
| Vendim i ERE nr. 50, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... | 2947 |
| Vendim i ERE nr. 51, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hydro Borshi” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Fterra”, “Fterra 1”..... | 2948 |
| Vendim i ERE nr. 52, datë 2.5.2012 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë hec “Ulëz - Shkopet” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... | 2949 |

DEKRET
Nr. 7429, datë 30.4.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Flora Nuo Gjinaj
2. Shyhrete Hysen Qeleposhi (Morina)
3. Hamza Ali Aksoy
4. Adem Hüseyin Çalişkan
5. Nilüfer Yusuf Çalişkan
6. Meryem Adem Çalişkan
7. Bahar Adem Çalişkan
8. Giuseppe Nicola Di Palma
9. Murat Abdurrahman Alakuş
10. Atilla Asim Kavrak
11. Qerim Feta Lahi
12. Hazir Demë Sadiku
13. Shemsi Bajram Ibrahim
14. Gazemnd Tair Kadriu
15. Jon Gazmend Kadriu
16. Anda Gazmend Kadriu
17. Fatbardha Niman Sula (Mustafa)
18. Müslüm Nusret Mamo
19. Arzu Süleyman Mamo
20. Deniz Berçem Müslüm Mamo
21. Awfa Majed Haddadin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7430, datë 2.5.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,



DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hikmet Sinan Ibrahim Inal
2. Nora Luan Gjakova
3. Labinot Nebih Çuni
4. Rauf Salih Dhomi
5. Anton Mustafa Cena

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET

Nr. 7460, datë 11.5.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Ilir Hazir Shaqiri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr. 284, datë 9.5.2012

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT 2012-2014 “PËR PARANDALIMIN
DHE GODITJEN E VEPRIMTARISË KRIMINALE TË TRAFIKIMIT TË MJETEVE
MOTORIKE TË VJEDHURA, TË KONTRABANDUARA DHE ME SHKELJE TË TJERA
LIGJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të veprimit 2012-2014 “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikimit të mjeteve motorike të vjedhura, të kontrabanduara dhe me shkelje të tjera ligjore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij veprimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN KOMBËTAR VEPRIMI, 2012–2014

**PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E VEPRIMTARISË KRIMINALE TË TRAFIKIMIT TË
MJETEVE MOTORIKE TË VJEDHURA, TË KONTRABANDUARA DHE ME SHKELJE TË TJERA
LIGJORE**

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 522, datë 23.4.2008, ka miratuar planin kombëtar të veprimit “Për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike”, me pjesëmarrjen e institucioneve kombëtare përgjegjëse, si: Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me strukturat e saj –sektori kundër trafikëve të paligjshme, Interpol Tirana, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria Kundër Krimin Financiar, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit); Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor); Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve); si dhe me përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme.

Qëllimi i Planit Kombëtar të Veprimit ka qenë konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional, zhvillimi e aplikimi i metodave të reja ligjore dhe institucionale në përshtatje me specifikën në vendin tonë të fenomenit të trafikimit të mjeteve motorike të vjedhura, si zhvillimi i mënyrave dhe metodave më efektive nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike.

Në Planin Kombëtar të Veprimit janë planifikuar veprime specifike të institucioneve kombëtare përgjegjëse gjatë procesit të trajtimit të makinave, si regjistrim, zhdoganim, verifikim, identifikim etj., me detyra që lidhen me bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarive midis tyre për shkëmbimin e shpejtë të informacioneve dhe krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta (online) për verifikim, me detyra për trajnime për forcimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe detyra për rritjen e ndërgjegjësimit e publikut në lidhje me këtë fenomen.

Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 23.4.2008 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike”, ka dhënë rezultate të larta në këto drejtime:



- dhënia e të drejtës së përdorimit në sistemin ASF2 të Interpolit, strukturave kundër trafikëve të paligjshme në qendër dhe bazë;
- dhënia e të drejtës së përdorimit në sistemin ASF2 të Interpolit, të gjitha pikave kufitare;
- dhënia e të drejtës së përdorimit në sistemin ASF2 të Interpolit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të kryer verifikimin e mjeteve para regjistrimit të tyre dhe targimit apo në momentin e ndërrimit të pronësisë së automjetit;
- shkëmbimi i informacionit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Policisë së Shtetit për ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore, kur mjetet rezultojnë të vjedhura pas verifikimit nga DPSHTRR-ja.

Objektivat e Planit të ri Kombëtar të Veprimit

1. Parandalimi i trafikimit të makinave të vjedhura.
2. Identifikimi i makinave të trafikuar, nëpërmjet përmirësimit të procedurave të gjetjes së makinave të vjedhura dhe bashkëpunimit me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit.
3. Identifikimi i trafikantëve të makinave, përfshirja e tyre në procese ligjore hetimi, përfundimi i hetimeve, dënimi i tyre dhe kthimi i makinave të vjedhura pronarëve të ligjshëm.
4. Trajnimi i burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Nisur nga rezultatet e arritura në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 23.4.2008, përvoja dhe problematika e evidentuar për zgjidhje, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kombëtare përgjegjëse dhe njëkohësisht adoptimin e mjeteve dhe metodave ligjore më efikase nga të gjitha këto institucione në luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike, në planin e ri kombëtar të veprimit në vija të përgjithshme janë parashikuar këto aktivitete:

I. Krijimi i një baze të dhënash në TIMS, ose një lidhje (link) ndërmjet kësaj baze të dhënash të re dhe TIMS, që bën të mundur një “vetëkontroll” të ngjashëm me sistemin ndërmjet Interpol dhe sistemit TIMS, për evidentimin e mjeteve të vjedhura në Republikën e Shqipërisë, si dhe regjistrimi i tyre në sistemin TIMS.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|---|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| <p>Grumbullimi i të dhënave për mjetet e vjedhura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga strukturat policore përkatëse në qarqe do të dërgohen informacionet mbi mjetet e vjedhura me të dhënat sipas tabelës së përcaktuar në urdhrin e DPPSH-së nr. 1219, datë 4.10.2010 dhe dërgimi i tyre në adresën elektronike: makinatëvjedhura@mrp.gov.al - Nga Drejtoria për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve në Departamentin për Sigurinë Publike në Policinë e Shtetit të grumbullohen të dhënat përkatëse dhe pas konstatimit se janë konform urdhrin të DPPSH-së nr. 1219, datë 4.10.2010 të krijohet një bazë të dhënash për menaxhimin sa më me efikasitet të këtyre informacioneve. Menaxhimi i të dhënave të automjeteve të vjedhura: - Një kopje e bazës së të dhënave për mjetet e vjedhura do t'i dërgohet sektorit | PSH(DSP, DTI) | Në vijim | Evidentimi i të gjitha automjeteve të vjedhura në territorin shqiptar në qendrën e të dhënave të Ministrisë së Brendshme dhe integrimi i këtyre të dhënave në qendrën e të dhënave të Interpolit. | Ekzistuese |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| <p>të kartotekës në DP-të. Policisë, me qëllim kryerjen e procedurave për shpalljen në kërkim të mjeteve të vjedhura.</p> <p>- Një kopje e bazës së të dhënave për mjetet e vjedhura do t'i dërgohet drejtorisë së TI, me qëllim regjistrimin e tyre në TIMS.</p> <p>- Në vazhdimësi do të rifreskohet baza e të dhënave mbi mjetet e vjedhura sipas ndryshimeve të ndodhura.</p> <p>Përdorimi i të dhënave:</p> <p>- Përdorimi i të dhënave të mjeteve të vjedhura për verifikim në sistemin TIMS nga përdoruesit në bazë të aksesit.</p> <p>Aktualisht ky projekt është në fazën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave bazuar edhe në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1219, datë 4.10.2010 "Për dërgimin në mënyrë periodike të të dhënave, në lidhje me veprimtarinë kriminale të vjedhjes së mjeteve.</p> | | | | |
|--|--|--|--|--|

II. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet DPSHTRR-së dhe DPPSH-së në bazë të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. prot. 4290/2, datë 26.11.2007.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|--|---|---------------------------|---|-------------------|
| <p>Në bazë të kësaj marrëveshjeje, DPPSH do të informojë për:</p> <p>- Mjetet motorike që hyjnë në territorin shqiptar dhe vërtetimin e kalimit kufitar (VKK) DPSHTRR bazuar në udhëzimin nr. 1 datë 18.1.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore" nuk kërkon VKK shkresor për mjetet motorike që regjistrohen për herë të parë, por duhet të bëjë leximin automatik të drejtpërdrejtë (online) në sistemin e DPPSH-së.</p> <p>- Mjetet motorike të vjedhura të regjistruara në sistemin ASF2 të Interpolit.</p> <p>- Mjetet motorike të sekuestruara dhe të kaluara në Rezervat e Shtetit.</p> <p>- Mjetet motorike të bllokuara.</p> <p>- Denoncime për humbje të dokumenteve dhe targave.</p> <p>- Mjetet motorike të trafikuar në vendin tonë.</p> <p>DPSHTRR do të informojë për:</p> <p>- Mjetet motorike të regjistruara për herë të parë në Republikën e Shqipërisë</p> | <p>PSH (DTI), DPSHTRR (DTI)</p> | <p>2012</p> | <p>Mundësia që Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera ligjbatuese të verifikojnë drejtpërdrejt targimin e mjeteve rrugore në sistemin përkatës duke krijuar një sistem të mbyllur unik gjithëpërfshirës.</p> | <p>Ekzistuese</p> |



| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| dhe mjetet, pronarët e të cilave kryejnë ndërrimin e pronësisë, ndryshimin e targave, pajisjen me certifikatë pronësie etj., të cilat dalin pozitive në sistemin ASF2 të Interpolit. - Të dhëna të tjera në lidhje me mjetet motorike dhe pronarët e tyre. - Të dhëna për drejtuesit e mjeteve motorike. | | | | |
|--|--|--|--|--|

III. Realizimi i dhënies së të drejtës së përdorimit në sistemin TIMS, shërbimit doganor, me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1022, datë 14.10.2009, lidhur me monitorimin për mbylljen e regjimit të përkohshëm të mjeteve me targa të huaja.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet financiare |
|--|---------------------------|---------------------------|---|--------------------|
| Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit “Për dhënien e të drejtës së përdorimit të bazës së të dhënave të DPD (Oracle Application Reports)” e nënshkruar më datë 30.9.2010 nga drejtuesit e DPPSH-së dhe DPD-së do të realizohet dhënia e të drejtës në TIMS të shërbimit doganor. Aktualisht shërbimi doganor ka realizuar informatizimin në të gjitha pikat doganore, kufitare për automjetet me regjim lejimi të përkohshëm, arritje kjo që mundëson përdorimin e sistemit për një kontroll më të mirë dhe efektiv të hyrje/daljeve të automjeteve me RLP në bashkëpunim me Policinë Kufitare. | DPD PSH | 2012 | Mundësia e një kontrolli më të mirë dhe efektiv të hyrje/daljeve të automjeteve me RLP nga dogana dhe Policia Kufitare. | Ekzistuese |

IV. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet shërbimit doganor dhe Policisë Rrugore, për mjete që kanë shkelur rregullat e lejimit të përkohshëm të qarkullimit të mjeteve me targa të huaja.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|--|---------------------------|---------------------------|--|------------|
| Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, në nenin 384 të së cilës përcaktohen rregulla të qarta për regjimin e lejimit të përkohshëm të mjeteve me targa të huaja. Nga ana e Policisë Rrugore të merren masa organizative për kontrolle ndaj mjeteve me targa të huaja me regjim të përkohshëm qarkullimi dhe penalizimet përkatëse. | DPD PSH | Në vijim | Blokimi dhe ndëshkimi ligjor i personave që përdorin mjete me targa të huaja në vendin tonë, në kundërshtim me dispozitat ligjore. | Ekzistuese |

V. Realizimi i dhënies së të drejtës së përdorimit, në sistemin ASF2 të Interpolit, organit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative pranë njësive rajonale të Policisë Rrugore

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|---|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| Për të gjitha mjetet që i nënshtrohen gjyqimit administrativ, të kryhet verifikimi në sistemin ASF2 të Interpolit, nëse rezultojnë të vjedhura/trafikuar, dhe raporti i përfuar të jetë pjesë e praktikës administrative për çdo rast. Në rast se nga kontrolli në sistemin ASF2 të Interpolit rezultojnë mjete të vjedhura/trafikuar, organi i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative pranë njësive rajonale të Policisë Rrugore, të njoftojë me shkrim strukturat kundër trafikevetëpaligjshme sipas juridiksionit, për nisjen e hetimeve të nevojshme. | PSH (DSP;DTI) | Në vijim | Bllokimi dhe sekuestrimi i mjeteve të vjedhura/të trafikuar dhe fillimi i hetimeve për autorët e kësaj veprimtarie kriminale. | Ekzistuese |

VI. Ndryshimi i urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1000, datë 2.9.2009 “Mbi përdorimin e sistemit ASF2 të Interpolit”.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|---|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| Për të realizuar dhënien e të drejtës së përdorimit në sistemin ASF2 të Interpolit, për organin e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative pranë njësive rajonale të Policisë Rrugore, duhet ndryshuar urdhri i DPPSH-së nr. 1000, datë 2.9.2009 “Mbi përdorimin e sistemit ASF2 të Interpolit”. | PSH | 2012 | Identifikimi i automjeteve të vjedhura/trafikuar nga shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative. | Ekzistuese |

VII. Regjistrimi në sistemin TIMS edhe i numrave të shasisë së mjeteve gjatë hyrje/daljeve për disa raste të veçanta.

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|--|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| 1. Të bëhet regjistrimi i numrave të shasisë së mjeteve për rastet: - Kur në PKK-të nuk ka fluks të mjeteve në kufi; - Kur mjetet hyjnë për herë të parë në kufi; - Kur mjetet kalojnë për kontroll në vijën e dytë; - Për mjetet e delegacioneve zyrtare që dalin nga Republika e Shqipërisë. 2. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit të bashkërendojë me homologët policorë | PSH (DKM) | 2013 | Rritja e mundësisë së identifikimit të mjeteve të trafikuar në vendin tonë. | Ekzistuese |



| | | | | |
|--|--|------|--|-----------|
| ndërkombëtarë ose donatorë të ndryshëm, me qëllim modernizimin e teknologjisë për lexues automatikë të numrave të shasisë së automjeteve për të gjitha pikat e kalimit kufitar në të gjithë territorin e vendit. | | 2014 | | Donatorët |
|--|--|------|--|-----------|

VIII. Përfundimi i zbatimit të projektit për monitorimin e PKK-ve

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|---|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| Monitorimi i PKK-ve të bëhet me sistem kamerash, ku imazhet të jenë të përdorshme nga shërbimi doganor dhe policia kufitare, përfshirë edhe lexuesit automatikë të numrave të shasisë së automjeteve që hyjnë e dalin në këto vendkalime. | DPD PSH | 2013 | Rritja e bashkëpunimit mes policisë kufitare dhe shërbimit doganor, për goditjen e aktiviteteve të kundërligjshme që lidhen me mjetet motorike. | Ekzistuese |

IX. Hedhja në një listë e mjeteve të vjedhura

| Aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | Afati kohor i përfundimit | Tregues | Burimet |
|--|---------------------------|---------------------------|---|------------|
| Në faqen në internet të Policisë së Shtetit të hapet edhe një rubrikë ku të hidhen në një listë mjetet e vjedhura, si pjesë e informacionit që policia jep për publikun. | PSH (DTI) | 2014 | Informimi i publikut në lidhje me automjetet e vjedhura në vendin tonë. | Ekzistuese |

SHKURTIMET E PËRDORURA

DPD- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
 DPSHTRR–Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
 PSH–Policia e Shtetit
 DTI–Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
 DSP–Departamenti për Sigurinë Publike në Policinë e Shtetit
 DKM–Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit

VENDIM

Nr. 286, datë 2.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 55, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 65 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “b” e pikës 1 të vendimit nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Dokumente tatimore, në kuptim të këtij vendimi, janë librat e blerjes dhe të shitjes së tatimpaguesve të regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 288, datë 2.5.2012

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE DHE SHTYRJES SË AFATIT TË PROGRAMIT, SIPAS MARRËVESHJES KUADËR TË HUAS, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, QË PËRFAQËSON REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEDB), PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “PUNËT E KOMUNITETIT, FAZA E TRETË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9910, datë 5.5.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e programit “Punët e komunitetit, faza e tretë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve dhe shtyrjes së afatit të programit, sipas marrëveshjes kuadër të huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB), për financimin e programit “Punët e komunitetit, faza e tretë”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E RIALOKUAR E FONDEVE QË FINANCOJNË PROGRAMIN
“PUNËT E KOMUNITETIT, FAZA III”

| Kategoria | Alokimi i fondeve të CEDB (shprehur në euro) | Alokimi i fondeve të qeverisë dhe NJQV (shprehur në euro) | Alokimi i fondeve në total (CEDB dhe qeverisë-NJQV) (shprehur në euro) |
|-------------------------------|---|--|---|
| 1. Kostot e investimit | 9,450,000 | 3,810,000 | 13,260,000 |
| 1.1 Punime | 9,450,000 | 3,100,000 | 12,550,000 |
| 1.2 Projektimi dhe mbikëqyrja | - | 710,000 | 710,000 |
| 2. Asistenca teknike | 180,000 | - | 180,000 |
| 3. Trajnime | 70,000 | - | 70,000 |
| 4. Mallra | 80,000 | 90,000 | 170,000 |
| 5. Kostot operative të FSHZH | 400,000 | 300,000 | 700,000 |
| 6. Kontigjenca | - | - | - |
| Totali | 10,180,000 | 4,200,000 | 14,380,000 |



VENDIM
Nr. 289, datë 2.5.2012

**PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHITESË KOMUNËS QENDËR BILISHT TË QARKUT
TË KORÇËS, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT EMERGJENT PËR NDËRTIMIN E URËS SË
POLOSKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Qendër Bilisht, në qarkun e Korçës, në buxhetin e vitit 2012, t’i jepet fondi financiar shtesë prej 44 934 000 (dyzet e katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë) lekësh, për zbatimin e projektit emergjent për ndërtimin e urës së Poloskës.
2. Ky fond financiar shtesë të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshme, komuna Qendër Bilisht dhe prefekti i qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 290, datë 2.5.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707, DATË 25.8.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
SË TENSIONIT TË LARTË 400 KV TIRANË - PODGORICË, QARKU TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e pronarëve, pasuritë e të cilëve janë shpronësuar me vendimin nr. 707, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave, të shtohen edhe pronarët Afrie Istrefi dhe Preng Gjoni, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE ME REFLEKTIMIN E NDRYSHIMEVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT
TË NDËRTIMIT TË LINJËS 400 KV TIRANË-PODGORICË, QARKU TIRANË

Rrethi: Tiranë

| Nr. | Objekti | Shpronësim definitiv | | | | | | | | | | | Vlera totale e kompensimit në lekë | Adresa e pronarit | Dokumentacioni |
|-----|---------|----------------------|--------|---------|------------------|---------------|----------------|----------------|---|---------------------------------------|---------------------|-----------|------------------------------------|-------------------------|----------------|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. kadastral | Nr. i pasurisë | Nr. i shtyllës | Sasia shpronësim definitiv m ² | Çmimi shitje ZRPP lekë/m ² | Vlera e kompensimit | | | | |
| 1 | Lit 400 | Arife | Hamit | Istrefi | Shtëpi | 2372 | 240/37 | 312-313 | 13.9 | 30800 | 428,120 | 428,120 | Kamëz | Me certifikatë pronësie | |
| 2 | Lit 400 | Preng | Nikoll | Gjoni | Shtëpi | 1649 | 53/31 | 305-306 | 118.1 | 36600 | 4,322,460 | 4,322,460 | Kamëz | Me leje legalizimi | |
| | | Shuma | | | | | | | | 132 m ² | | 4,750,580 | | | |

VENDIM

Nr. 294, datë 2.5.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE SPECIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE SPECIALE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit (këtu më poshtë referuar si Palët),

duke dëshiruar forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të tyre miqësore, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, përfshihen pasaportat e mëposhtme:

Për Republikën e Shqipërisë: pasaportat e vlefshme diplomatike.

Për Shtetin e Katarit: pasaportat e vlefshme diplomatike dhe speciale.



Neni 2

Qytetarët e të dyja palëve, që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 më lart, mund të hyjnë në territorin e palës tjetër pa viza dhe mund të qëndrojnë atje për një periudhë deri nëntëdhjetë ditë nga data e hyrjes.

Neni 3

Qytetarët e të dyja vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 më lart, që janë të emëruar të punojnë në misionet diplomatike, tregtare, konsullore ose në organizatat ndërkombëtare të akredituara në territorin e palës tjetër, mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e kësaj pale pa viza gjatë periudhës së detyrës së tyre.

Neni 4

Anëtarët e familjeve të personave të specifikuar në nenin 3 më sipër, që banojnë me ata dhe janë mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1, mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e palës tjetër pa viza gjatë periudhës së detyrës së këtyre personave.

Neni 5

Në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, qytetarët e të dy vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1 dhe që dëshirojnë të hyjnë në territorin e secilës palë për qëllime pune, profesionale ose studimi, janë të detyruar të sigurojnë më parë vizë.

Neni 6

Qytetarët e të dyja palëve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, do të kalojnë kufijtë e territorit të secilës palë në pikat ligjore të kalimit kufitar të hapura për trafikun transit ndërkombëtar.

Neni 7

Secila palë ka të drejtë të refuzojë hyrjen ose qëndrimin në territorin e vet të qytetarëve të palës tjetër, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit dhe shëndetit publik.

Më tej, çdo palë ka të drejtë të reduktojë ose përfundojë periudhën e qëndrimit të qytetarëve të palës tjetër, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit pritës.

Neni 8

Qytetarët e të dyja vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, respektojnë ligjet dhe rregullat gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër.

Neni 9

1. Çdo palë ka të drejtë të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit dhe të shëndetit publik. Një vendim i tillë i bëhet i njohur me shkrim palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda 72 orëve, para hyrjes së tij në fuqi.

2. Pala që ka vendosur të marrë masat e specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për shfuqizimin e këtyre masave dhe rinisjen e kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe para se ajo të hyjë në fuqi, autoritetet kompetente të secilës palë shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike, ekzemplarët përkatës të pasaportave të tyre të vlefshme diplomatike dhe zyrtare brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

2. Në qoftë se njëra palë rinovon ose ndryshon pasaportat e veta diplomatike ose speciale, autoritetet e saj kompetente informojnë dhe dërgojnë ekzemplarët e rinj tek autoritetet kompetente të palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike para 30 ditëve nga data e futjes së tyre në qarkullim.

Neni 11

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me konsensusin e të dyja palëve dhe ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e specifikuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit që njëra palë i dërgon palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke deklaruar përfundimin e procedurave të saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 vjetësh dhe rinovohet automatikisht për periudha të ngjashme.

Secila palë mund ta anulojë këtë marrëveshje duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër dhe në këtë rast marrëveshja pushon së qeni në fuqi pas 30 ditësh nga data kur pala tjetër merr njoftimin për anulimin e saj.

Nënshkruar në Doha, më 26 mars 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha të barabarta dhe në rast të ndryshimeve në interpretim, teksti anglisht do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 295, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ishëm të qarkut të Durrësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 549 (pesëqind e dyzet e nëntë).

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ishëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Komuna Ishëm

Lidhja nr. 1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|----------------------|
| 1-14 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 15-21 | Prona që përdoren për realizimin e programeve shëndetësore | Në pronësi |
| 22-32 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 322-335, 337, 339, 389-428 | Infrastrukturë (rrugë vendore) | Në pronësi |
| 343-344, 349, 354, 359, 364-365, 370, 372, 376, 378, 379, 384, 388, 472, 473, 487, 493, 506, 524, 525, 532, 533, 547, 549 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta) | Në pronësi |
| 340-342, 345-348, 350-353, 373-375, 385-387, 356-358, 361-363, 367-369, 380-382 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |

VENDIM
Nr. 296, datë 2.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 5 të kreut XXX, të lidhjes bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë së komunës, për komunën Ksamil, të bëhet 3 (tre) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkisë dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 099 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 297, datë 2.5.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
ISH-UZINËS SË RAFINIMIT TË BAKRIT, RUBIK, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 5 pika 3 e 23 pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të ish-Uzinës së Rafinimit të Bakrit, Rubik, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3,5 % të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të ish-Uzinës së Rafinimit të Bakrit, Rubik, që i jepet shoqërisë “AMG Group Albania”, sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 298, datë 2.5.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE “SHKOPETI 2” DHE “SHKOPETI 3” DHE MIRATIMIN E BONUSIT,
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Shkopeti 2” dhe “Shkopeti 3”, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Shkopeti”, sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Shkopeti 2” dhe “Shkopeti 3” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 1, datë 9.5.2012

PËR MIRATIMIN E LOGOS KOMBËTARE TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË, SË BASHKU ME SHKRIMIN “100 VJET PAVARËSI” DHE PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË SAJ

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe të pikës 3 të vendimit nr. 782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komisionit Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive Festive për “Vitin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Komisioni Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive Festive për “Vitin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e logos kombëtare të 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, së bashku me shkrimin “100 Vjet Pavarësi”, sipas modelit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Logoja kombëtare e 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë përdoret në:

- Dekretet e Presidentit;
- Vendimet e Kuvendit;
- Aktet e Këshillit të Ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e Kryeministrit;
- Urdhrat dhe udhëzimet e ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kuvendit;
- Vendimet e institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e rektoratit të universiteteve;
- Dokumentet e krijuara nga autoritetet publike;
- Veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse, kur ato zhvillohen në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë. Për përdorimin e logos organizatat njoftojnë Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Përmasat e logos në një letër format A4 janë: e lartë: 34.5 mm; e gjerë: 36 mm; shkrimi “100 Vjet Pavarësi” vendoset në mes, poshtë flakadanit shqiponjë dhe është 20.5 mm i gjerë e 3.6 mm i lartë. Logoja vendoset gjithmonë lart, djathtas. Ajo qëndron rreth 15 mm larg skajit anësor dhe 15 mm poshtë skajit të sipërm të letrës në faqen e parë të aktit ose dokumentit, sipas modelit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Logoja të përdoret në posterat dhe ftesat e veprimtarive të rëndësishme shtetërore dhe ndërshtetërore, që do të zhvillohen në kuadër të 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.

5. Logoja përdoret edhe për prodhimin e një steme të përmasave të vogla, e cila mund të vendoset si distinktiv gjatë ceremonive të ndryshme zyrtare, shtetërore dhe ndërshtetërore.

6. Logoja nuk zëvendëson në asnjë rast stemën e Republikës, por përdoret së bashku me të. Logoja, ashtu si dhe stema e Republikës, vendoset në të gjitha aktet zyrtare të sipërpërmendura gjatë gjithë vitit 2012.

7. Logoja, kur paraqitet e shoqëruar me stema shtetesh të tjera, vendoset në një vend të dukshëm, së bashku me stemën e Republikës ose në të njëjtin vend me to.


8. Logoja të shkarkohet nga faqja elektronike zyrtare e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

9. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT
Sali Berisha

Modeli nr. 1





Modeli nr. 2

↓ 15 mm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

.....



100 Vjet Pavarësi

15 mm ←

UDHËZIM
Nr. 4, datë 24.4.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 338/3, DATË 10.3.2006 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 38 të vendimit nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bëhen këto ndryshime:

1. Në seksionin I, pas pikës 10 shtohet pika 11.

“11. Për anëtarin e familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, nuk i llogaritet masa e ndihmës ekonomike si individ në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

Për shembull:

a) Familja është me dy anëtarë, kryefamiljari është person me aftësi të kufizuara (i verbër, invalid pune, para dhe tetraplegjik apo fizik dhe mendor), anëtari i dytë është person në moshë pune, atëherë llogaritja e masës së ndihmës ekonomike për këtë familje do të jetë vetëm për anëtarin e dytë, pra masa e ndihmës ekonomike që do të përfitohet është 600 lekë në muaj.

b) Familja është me tre anëtarë, kryefamiljari, një anëtar në moshë pune dhe një anëtar nën moshë pune. Anëtari në moshë pune është person me aftësi të kufizuara (i verbër, invalid pune, para dhe tetraplegjik apo fizik dhe mendor). Masa e ndihmës ekonomike për anëtarin në moshë pune nuk llogaritet në strukturën e kësaj familjeje, pra administratori shoqëror për këtë familje me tre anëtarë do të llogarisë 2600 lekë + 700 lekë = 3.300 lekë si ndihmë ekonomike.”

2. Seksioni V.1 shfuqizohet.

3. Pika 17 e seksionit XI zëvendësohet me paragrafin:

“17. Ndihma ekonomike e familjes përfituese tërhiqet pranë sporteve të bankave/Postës Shqiptare nga bashkëshortët/individët që do të administrojnë paratë, sipas deklarimit në modularin 2”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA**
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr. 11, datë 14.5.2012

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave



UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Në paragrafin e dytë të pikës 8.7 “Operacionet hidrokarbure”, pas fjalëve “... të importuara sipas nenit 26/1 të këtij ligji” shtohet ky paragraf:

“Në rastin e importimit të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione, për të përfituar përjashtimin nga TVSH-ja në import, subjektet duhet të paraqesin pranë organit doganor një vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për kontraktorët dhe nënkontraktorët, së bashku me listën e mallrave të importuara.

Brenda datës 5 të çdo muaji, administrata doganore i përcjell administratës tatimore listën e detajuar të mallrave të importuara nga kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Në rastin e importimit të nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, përjashtimi nga TVSH-ja jepet për produktet dhe sasitë e përcaktuara në autorizimet e përjashtimit të akcizës të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, udhëzimi nr. 3, datë 4.5.2012 “Për përcaktimin dhe dokumentimin e sasive të nënprodukteve të naftës, të importuara për nevojat e veta, nga shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR Nr.224, datë 25.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 8046, DATË 2.12.2004 “PËR KUSHTET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË ZYRË NOTERIALE PËR TË MUNDËSUAR USHTRIMIN NORMAL TË VEPRIMTARISË SË NOTERIT”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe paragrafit 3 të nenit 12 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Në urdhrin nr. 8046, datë 2.12.2004 “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Zyra duhet të jetë e pajisur:

a) me ndriçim të mjaftueshëm;

b) me kompjuter i cili duhet të ketë karakteristikat minimale sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri si dhe elemente të tjera ndihmëse, shërbim interneti 24 orë dhe llogari elektronike identifikuese, e cila përmban të dhëna mbi *username*, *password* dhe nënshkrim (të dhënat e shenjave të gishtit), me qëllim realizimin e aksesimit në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme;

- c) me tavolinë të përshtatshme;
- ç) me ndenjëse;
- d) me rafte për mbajtjen e dokumentacionit arkivor dhe regjistrave dhe kur është e mundur;
- dh) me kasafortë; dhe
- e) me pajisje të tjera komunikimi (telefon, faks, fotokopje), të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre.”.

II. Ngarkohen noterët dhe strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

ANEKSI NR.1

1. PC, me këto karakteristikat minimale:

- Min RAM 512, Pentium III
- Internet Browser: Internet Explorer, Mozilla Firefox or Google Chrome
- usb 2 ports
- OS: Windows XP ose Windows 7 32 bit

VENDIM

Nr. 40, datë 2.5.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE “GEN – I TIRANA” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “A” pika 3, pikës 7 germa “g” të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 1510/2 prot., datë 30.3.2012, midis OST sh.a. dhe “GEN–I Tirana” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a. dhe “GEN – I Tirana” sh.p.k., janë subjekte të licencuara nga ERE respektivisht me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.3.2009, për aktivitetin e transmetimit dhe me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 129, datë 2.12.2008, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, modelin e tregut të energjisë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 “Rregullat e tregut”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 146 datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”.

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve



VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “GEN-I Tirana” sh.p.k., me ndryshimet si më poshtë:

Pika 5.14 përpunohet si më poshtë:

Pika 5.14

Në rast kur “GEN-I Tirana” sh.p.k. nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a., ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës, të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonese, por jo më shumë se vlera e vetë faturës.

Pika 5.15 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 41, datë 2.5.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Salillari” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 42, datë 2.5.2012

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI”
SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE NGA “HEC VERTOP”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar dhe neneve të 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Vertop” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Salillari” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues si burim i rinovueshëm energjie nga “Hec Vertop”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 43, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “BINDI” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me



vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Bindi” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Bindi” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 44, datë 2.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HENZ ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 45, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HENZ ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE NGA HEC-ET:
“DARSI 1”, “DARSI 2” DHE “DARSI 3”, SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGIJE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar dhe neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et: “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese nga hec-et: “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3”, si burime të rinovueshme energjie.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 46, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDAT LURA” SHPK
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “LURA 1”,
“LURA 2” DHE “LURA 3”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erdat Lura” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 47, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ERDAT LURA”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 48, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të



Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 49, datë 2.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ASHTA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ashta” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ashta” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 50, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “YLLIAD” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ylliad” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 51, datë 2.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO BORSHI”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET:
“FTERRA”, “FTERRA 1”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Borshi” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Borshi” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Borshi” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Fterra” dhe “Fterra 1”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 52, datë 2.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË HEC “ULËZ - SHKOPET” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9, nenit 13 pika 1 germa “ç” dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria hec “Ulëz - Shkopet” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë hec “Ulëz - Shkopet” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht (mungon neni 9 pika 3 germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore)).
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat: “a”, “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë hec “Ulëz - Shkopet” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.5.2012
Doli nga shtypi më 29.5.2012

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë